

TÜRKİYE DİYANET İŞLERİ BAŞKANLIĞI

**Pyetje të shpeshta rreth  
agjërimit**

Nga turqishtja:  
**Rehan Neziri**

Kreuzlingen, 2026

## **PËRMBAJTJA**

<b>PARATHËNIE</b> .....	V
<b>I. URTIA DHE DOBITË E ADHURIMIT TË AGJËRIMIT</b> .....	1
<b>II. DISA NJOHURI TË PËRGJITHSHME RRETH AGJËRIMIT</b> .....	4
1. Cilat janë kushtet për të qenë i obliguar me agjërime?.....	4
2. A është kusht shikimi i hënës së re për të filluar me agjërime?.....	4
3. Cilat janë arsyet që e bëjnë të lejueshëm mosagjërime?.....	6
4. A është e lejueshme që punëtorët të mos agjërojnë nga frika e rënies së rendimentit në punë? .....	9
5. Çfarë do të thotë fidja e agjërimit? .....	10
6. Kur dhe si bëhet nijeti për agjërime?.....	11
7. Çfarë është imsaku? Kur fillon? .....	12
8. A mund të vazhdohet ngrënia dhe pirja për pak kohë kur fillon ezani i sabahut?.....	13
9. A agjërohet në ditët e Bajramit?.....	14
10. Cili është statusi i agjërimit në ditën e xhuma?.....	14
11. Cili është vendi i tre muajve në fe dhe cili është statusi i agjërimit në këta muaj? .....	15
12. A ka detyrim që agjërimet e mbetura kaza nga Ramazani të plotësohen brenda një afati të caktuar? .....	16
13. Nëse një person ka shumë agjërimet kaza, si duhet t'i plotësojë? .....	16
14. A kërkohet kaza për agjërimet vaxhib dhe nafile që prishen?.....	17
15. Cili është statusi i agjërimit të Shevalit? .....	18
16. Cili është statusi i agjërimit në ditën e Ashures? .....	18
17. A agjërohet për ta pritur Ramazanin? .....	19
18. Si mund ta përmbushë agjërimin personi që, për shkak të profesionit, udhëton vazhdimisht? .....	19
19. Personi që udhëton me avion, sipas cilit vend e bën iftarin? ..	20

20. Nëse gjatë abdesit, pa dashje, i shkon ujë në fyt agjëruesit, a i prishet agjërimi?.....	21
21. A e prish agjërimin larja ose hyrja në det? .....	21
22. A është i vlefshëm agjërimi kur njeriu është xhunub? .....	22
23. Çfarë është sadakaja e fitrit dhe kur jepet? .....	22
24. Kujt mund t'i jepet sadakaja e fitrit dhe kujt nuk mund t'i jepet? .....	23
25. Si paguhet fidja e agjërimit?.....	24
26. Kujt mund t'i jepet fidja e agjërimit?.....	24
27. A lirohet nga borxhi i agjërimit duke dhënë fidje ai që ka pasur fuqi të agjërojë, por nuk ka agjëruar? .....	25

### **III. GJËRAT QË E PRISHIN DHE ATO QË NUK E PRISHIN AGJËRIMIN .....**

28. Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin? .....	26
29. Cilat janë rastet që e prishin agjërimin dhe kërkojnë vetëm kaza?.....	26
30. Nëse një person gjatë Ramazanit niset për udhëtim dhe e prish agjërimin për shkak të udhëtimit, çfarë kërkohet?.....	28
31. Cili është gjykimi i prishjes së qëllimshme të agjërimit? .....	28
32. A e prish agjërimin ngrënia dhe pirja nga harresa? .....	29
33. A e prish agjërimin larja e dhëmbëve? .....	29
34. A e prish agjërimin vjellja? .....	30

### **IV. PROBLEMET SHËNDETËSORE DHE AGJËRIMI .....**

35. Çfarë duhet të bëjë personi të cilit një mjek specialist i rekomandon të mos agjërojë?.....	31
36. Cila është përgjegjësia e agjërimit për personat që janë në grup rreziku për sa i përket sëmundjes?.....	32
37. A e prish agjërimin spreji dhe ilaçi që përdorin të sëmurët me astmë? .....	33
38. A e prishin agjërimin pikat në sy? .....	34
39. A e prishin agjërimin pikat në hundë? .....	34
40. A e prishin agjërimin pikat në vesh? .....	35
41. A e prish agjërimin larja e veshit? .....	35
42. A e prish agjërimin tableta nën gjuhë që e përdorin të sëmurët nga zemra? .....	36

43. A duhet të agjërojnë personat që janë të detyruar të përdorin çdo ditë barna në formë tabletash?.....	36
44. A e prish agjërimin endoskopia, kolonoskopia ose ekografia nga anusi apo vagina? .....	37
45. A e prish agjërimin kryerja e biopsisë?.....	37
46. A e prish agjërimin vizualizimi i kanalit urinar ose futja e ilaçit në të? .....	38
47. A e prish agjërimin anestezia? .....	38
48. A e prish agjërimin përdorimi i supozitorëve (fitilëve) dhe bërja e klizmës?.....	38
49. A e prish agjërimin vaksina ose injeksioni? .....	39
50. A e prish agjërimin injeksioni i insulinës që e përdorin të sëmurët me diabet?.....	40
51. A e prish agjërimin dhënia e gjakut ose marrja e gjakut gjatë agjërimit?.....	40
52. A prishet agjërimi gjatë dializës?.....	41
53. A e prish agjërimin kryerja e angiografisë? .....	41
54. A e prish agjërimin trajtimi me akupunkturë? .....	42
55. A e prish agjërimin përdorimi i fashave me ilaç? .....	42
56. A e prish agjërimin trajtimi dentar? .....	42
57. A e prish agjërimin gjakderdhja e dhëmbëve dhe gëlltitja e gjakut të përzier me pështymë?.....	43
58. A e prish agjërimin gëlltitja e tabletës pa ujë? .....	43
59. Ata që e kalojnë Ramazanin dhe Bajramin në vende të tjera, nëse llogaritjet/takvimet e atij vendi ndryshojnë nga vendlindja, a duhet ta festojnë Bajramin sipas vendlindjes apo sipas vendit ku ndodhen? .....	44
<b>V. GRATË NË GJENDJET E VEÇANTA DHE AGJËRIMI .....</b>	<b>45</b>
60. A mund të agjërojnë gratë gjatë ditëve të tyre të veçanta?.....	45
61. Si duhet të agjërojë një grua që ka gjakderdhje të çrregullt? .	45
62. Çfarë duhet të bëjë një grua që ka bërë nijet për agjërim, por gjatë ditës i vijnë menstruacionet?.....	46
63. A është e lejueshme që gratë në Ramazan të përdorin ilaçe për shtyrjen e menstruacioneve? .....	47
64. A mund të agjërojnë gratë gjatë shtatzënisë?.....	47
65. A mund të agjërojë një grua që ka pasur abort? .....	48

## **PARATHËNIE**

Një nga mjetet përmes të cilave Kryesia jonë, e ngarkuar me detyrën e ndriçimit fetar të shoqërisë, e përmbush këtë mision, është shërbimi i përgjigjes ndaj pyetjeve fetare që i drejtohen nga populli ynë. Pyetjet me karakter fetar, të parashtruara nga qytetarët tanë si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij - qoftë nëpërmjet letrave, telefonit, faksit, postës elektronike apo nëpërmjet paraqitjes personale - shqyrtohen dhe marrin përgjigje nga Këshilli ynë i Lartë për Çështje Fetare.

Këshilli ynë ka vendosur që përmbledhja e pyetjeve dhe përgjigjeve të hartuara nën titullin “Pyetje të Shpeshta” të botohet në formë serie, në stilin e broshurave të xhepit. Në këtë kuadër, në vitet e kaluara janë përgatitur dhe botuar në mënyrë të njëpasnjëshme broshura me titullin “Pyetje të Shpeshta” mbi tema të ndryshme si Haxhi, Agjërimi, Zekati dhe Kurbanet. Synohet që kjo seri të vazhdojë edhe me tituj të tjerë tematikë, sipas nevojave që paraqiten. Duke u mbështetur në reagimet pozitive të marra si nga nëpunësit fetarë që shërbejnë pranë Kryesisë sonë, ashtu edhe nga populli ynë, është parë si e përshtatshme që broshurat e përfshira në këtë seri të rishikohen nga Këshilli, të plotësohen me shtesa aty ku është e nevojshme dhe të ribotohen në një formë të përmirësuar.

Përgjigjet e përfshira në këto broshura janë të një natyre që nuk ndryshon sipas individëve; ato janë të hartuara për përdorim praktik dhe synojnë të sigurojnë një unitet në dhënien e fetvave. E lusim Allahun e Madhëruar që këto broshura të përgatitura të jenë të dobishme, para së gjithash për Myftinitë tona, për Zyrat e Familjes dhe të Udhëzimit pranë tyre, për nëpunësit fetarë, si edhe për të gjithë qytetarët tanë që shfaqin interes për këto çështje.

Këshilli i Lartë për Çështje Fetare i Turqisë

## I. URTIA DHE DOBITË E ADHURIMIT TË AGJËRIMIT

Urdhurat dhe ndalesat e Allahut janë, pa dyshim, për të mirën e njerëzve. Dijetarët islamë janë njëzëri në mendimin se të gjitha dispozitat fetare synojnë realizimin e dobisë së njeriut. Është një e vërtetë e pamohueshme se në atë që Allahu ka urdhëruar ka dobi të mëdha për njerëzit, ndërsa në atë që Ai ka ndaluar fshihen dëme të rënda. Të shtyrë nga përgjegjësia që u ngarkon mësimi islam, dijetarët e Islamit, prej kohësh, janë thelluar në shqyrtimin e urtisë dhe dobive të adhurimeve të ndryshme. Ata janë përpjekur që këto adhurime të mos shihen thjesht si praktika me përfitime të drejtpërdrejta individuale, por si mjete funksionale për pastrimin, edukimin dhe ngritjen shpirtërore të njeriut. Në këtë kuadër, ndonëse janë identifikuar disa prej dobive dhe urtive që burojnë nga adhurimet me të cilat janë ngarkuar njerëzit, mbetet po ashtu një e vërtetë se jo të gjitha dobitë dhe qëllimet e synuara prej tyre mund të përfshihen apo të kuptohen plotësisht nga mendja njerëzore. Ibadeti i agjërimit ka për synim themelor ta çojë njeriun drejt *takvasë*. Kjo shprehet qartësisht në Kur'an: *“O ju që besuat! Agjërimi ju është bërë detyrë, ashtu siç u qe bërë detyrë edhe atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.”* (el-Bekara, 2:183). Agjërimi e forcon ndjenjën e mjaftueshmërisë dhe të kënaqjes me atë që e kemi. Njeriu që e përjeton urinë e kupton më thellë gjendjen e të varfrit dhe të nevojtarit; ai e ndien në shpirt peshën e mungesës dhe e mëson vlerën e përmbajtjes. Ai nuk e shpërdoron më dhunti-

në. Në veshët e besimtarit kumbon fjala e Muhammedit s.a.v.s.: *“Kënaqja me atë që ke është një thesar që nuk shteron.”* (Bejhekiu, Zuhd, 2/88). Njeriu që fillon ta çmojë më shumë mirësinë, e shton falënderimin ndaj Allahut. Ai kupton se lakmia çon në varfëri shpirtërore, ndërsa kënaqja në mëshirë. Përgëzimi i Muhammedit s.a.v.s. - *“Ai që është i matur në shpenzim, nuk bie në vështirësi jetese.”* (Ibn Ebi Shejbe, *el-Musannef*, 5/331) - nis të marrë formë konkrete në jetën e tij. Agjërimi, nëpërmjet iftarit dhe syfyrit, nëpërmjet namazeve të teravisë dhe adhurimeve të tjera, ia jep njeriut mundësinë ta rregullojë jetën, t’i vendosë asaj një ritëm të ri, më të disiplinuar dhe më të ndërgjegjshëm.

Muaji i agjërimit, Ramazani, është i mbushur me mundësi dhe thesare shpirtërore, të vendosura në udhën e jetës që njeriu, duke iu drejtuar Zotit të tij, të kërkojë faljen e mëkateve. Në këtë muaj, njeriu gjen më shumë hapësirë për t’u thelluar në meditimin mbi Kur'an. Me begatinë që sjell Ramazani, zemra bëhet më e ndjeshme; njeriu merr më shumë shije prej Fjalës Hyjnore, e dëgjon dhe e kupton atë me vetëdije më të thellë. Agjërimi, si zekat i trupit që është, i jep metabolizmit një mundësi të vyer për t’i larguar elementet e dëmshme të grumbulluara. Në këtë muaj, kur njeriu fillon ta shohë trupin e vet jo thjesht si materie, por si një bashkim të mistershëm e harmonik të lëndës dhe shpirtit, trupat ripërtërihen dhe mendjet ndriçohen. Sikur të vinte si një vërtetim i fjalës së Muhammedit s.a.v.s.: *“Agjëroni që të gjeni shëndet”* (Taberaniu, *Mu’xhemu’l-Evsat*, VIII, 174), trupat tanë gjejnë lehtësim e gjallëri. Agjërimi i Ramazanit është një stinë ku edhe zemrat e lodhura nga dëshpërimi e rigjejnë shpresën e faljes. Ai është një mësues i heshtur që e mëson njeriun të

jetë i qëndrueshëm përballë sprovave të papritura. Ramazani është muaji që u jep fëmijëve tanë mundësinë ta mësojnë dhe ta jetojnë fenë duke e përjetuar atmosferën e saj - duke e thithur me frymëmarrje shpirtërore dhe duke e mishëruar në jetën e përditshme.

I Dërguari i Allahut, Muhammedi s.a.v.s., ka përgëzuar se atyre që e jetojnë Ramazanin me besim të sinqertë dhe duke e shpresuar shpërblimin vetëm prej Allahut, u falen mëkatet e kaluara (Nesiu, "Iman", 21). Po ashtu, duke iu drejtuar sahabiut Ka'b b. Uxhre, ai ka thënë: *"O Ka'b! Namazi është dëshmi e muslimanllëkut të njeriut. Agjërimi është një mburojë e fortë. Lëmosha i shuan mëkatet ashtu siç uji që e shuan zjarrin. O Ka'b! Mishit dhe eshtrave që janë formuar duke u ushqyer me haram, nuk u ka hije tjetër veçse zjarri."* (Tirmidhiu, "Xhum'a", 79).

Midis kuptimit të urtive të agjëritimit dhe të dispozitave të tij ekziston një lidhje e ngushtë. Sa më thellë të kuptohen qëllimet dhe domethëniet e këtij adhurimi, aq më vetëdijshëm zbatohen rregullat e tij. Njohja e normave që lidhen me përmbushjen e agjëritimit na mundëson ta kryejmë atë në përputhje me sunetin që Muhammedi s.a.v.s. na e ka lënë si trashëgimi urtie.

## **II. DISA NJOHURI TË PËRGJITHSHME RRETH AGJËRIMIT**

### **1. Cilat janë kushtet për të qenë i obliguar me agjërim?**

Sipas Islamit, kushtet themelore që e bëjnë individin përgjegjës janë: të jetë musliman, me mendje të shëndoshë dhe ta ketë arritur moshën e pjekurisë (*bulug*). Rrjedhimisht, këto janë edhe kushtet për të qenë i obliguar me agjërim. Sipas kësaj, që agjërimi i muajit Ramazan të jetë farz për një person, ai duhet para së gjithash të jetë musliman, me mendje të shëndoshë dhe ta ketë arritur pjekurinë. Edhe pse nuk janë të ngarkuar me detyrime fetare, fëmijët që nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë nxiten të falin namaz dhe të agjërojnë me qëllim ushtrimi dhe mësimi gradual. Në të vërtetë, Muhammedi s.a.v.s. ka rekomanduar që fëmija, nga mosha shtatë deri në dhjetë vjeç, të mësohet me namazin (Ebu Davudi, Salah, 26).

### **2. A është kusht shikimi i hënës së re për të filluar me agjërimin?**

Muajt hënorë, siç kuptohet edhe nga vetë emërtimi, janë muajt fillimi dhe mbarimi i të cilëve përcaktohet sipas lëvizjeve të hënës. Meqenëse agjërimi i Ramazanit kryhet në muajin Ramazan dhe ky muaj, sipas kalendarit hënor, ndryshon çdo vit, për të filluar agjërimin duhet së pari të përcaktohet hyrja e muajit Ramazan. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: “Kur

*ta shihni hilalin (hënën e re, të Ramazanit), filloni agjërimin; dhe kur ta shihni hilalin (e Shevalit), festoni Bajramin. Nëse moti është i vranët, plotësojeni muajin në tridhjetë ditë.*” (Buhariu, Saum, 5, 11; Muslimi, Sijam, 3-4, 7-9). Në shikim të parë, ky hadith krijon përshtypjen se pa u parë *hilali* me sy të lirë nuk duhet të fillohet agjërimi dhe as të festohet Bajrami. Mirëpo, kur merren në konsideratë edhe transmetime të tjera mbi këtë çështje, kuptohet se qëllimi i këtyre haditheve ka qenë të mësohet metoda më e përshtatshme sipas kushteve të asaj kohe. Në një transmetim tjetër, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: “*Ne jemi një popull ummij (i paarsimuar); nuk dimë të bëjmë llogari dhe as të shkruajmë. E dimë vetëm se muaji ka ose 29, ose 30 ditë.*” (Buhariu, Saum, 13; Muslimi, Sijam, 15; Ebu Davudi, Saum, 4). Me këtë ai ka lënë të kuptohet se për përcaktimin e fillimit të muajve hënorë mund të merret parasysh edhe metoda e llogaritjes. Qoftë të shihet me sy të lirë apo jo, hëna e vazhdon lëvizjen e saj të rregullt. Në Kur'an theksohet se dielli dhe hëna lëvizin sipas një përlllogaritjeje të caktuar (er-Rahman, 55:5), se ato janë bërë, ndër të tjera, edhe si mjete matjeje (el-En'am, 6:96), se hënës i janë caktuar faza për ta ditur numrin e viteve dhe llogarinë e kohës (Junus, 10:5), se me krijimin e qiejve dhe të tokës është vendosur një rend prej dymbëdhjetë muajsh (et-Teubeh, 9:36), dhe se fazat e hënës – duke filluar nga *hilali* (hëna e re) e duke u shfaqur shkallë-shkallë në forma të ndryshme - janë masa kohore për njerëzit dhe për Haxhin (el-Bekara, 2:189). Prandaj, Muhammedi s.a.v.s. e ka përmendur shikimin e hënës së re me sy të lirë jo si metodën e vetme të mundshme, por si mënyrën më të sigurt sipas kushteve të kohës së tij. Qëllimi i vëzhgimit të hënës së re është të përcaktohet hyrja e muajit

Ramazan. Për këtë arsye, përveç shikimit me sy të lirë, është e lejueshme të përdoren edhe metoda të tjera që na çojnë drejt këtij qëllimi. Sot, zhvillimi teknologjik i njerëzimit na mundëson ndjekjen me saktësi të madhe të lëvizjeve të hënës. Madje, nëpërmjet llogaritjeve të imta astronomike, është bërë e mundur përgatitja e kalendarëve që tregojnë kohët e namazit për vite me radhë. Si rrjedhojë, përcaktimi i fillimit të muajve hënorë nëpërmjet metodës së llogaritjes është i lejueshëm.

### **3. Cilat janë arsyet që e bëjnë të lejueshëm mosagjërimin?**

Feja Islame, si parim, i ngarkon njerëzit me përgjegjësi sipas mundësisë së tyre dhe, në raste që e tejkalojnë fuqinë apo shkaktojnë vështirësi të mëdha, sjell dispozita lehtësuese. Në përputhje me këtë parim të përgjithshëm, për agjërimin farz të Ramazanit janë parashikuar disa lehtësime (*ruhsah*) që e lejojnë shtyrjen e tij në rrethana të caktuara. Në Kur'an thuhet:

*“O ju që besuat! Agjërimi ju është bërë detyrë, ashtu siç u qe bërë detyrë edhe atyre para jush, që të bëheni të devotshëm. (Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompenzim, ushqim (ditor), i një të varfëri. Ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.”*  
(el-Bekara, 2:183-184)

Dijetarët islamë, duke u mbështetur në këtë ajet fisnik dhe në hadithet përkatëse, i kanë renditur kështu arsyet që e bëjnë të lejuar mosagjërimin e Ramazanit:

**Udhëtimi:** Ai që gjatë Ramazanit nisët për një udhëtim në një distancë që konsiderohet udhëtim (*sefer*) – pra të paktën nëntëdhjetë kilometra (90 km) – mund të mos e bëjë nijetin e agjërimin që nga nata. Megjithatë, nëse e ka bërë nijetin dhe më pas gjatë ditës nisët për udhëtim, atëherë, nëse gjatë udhëtimit nuk ka ndonjë arsye tjetër të ligjshme, nuk duhet ta prishë agjërimin. Një adhërim i nisur duhet të përfundohet, përveç nëse ekziston një arsëtim i vlefshëm. Meqenëse udhëtimi përbën një arsë të ligjshme, nëse personi e prish agjërimin pasi ka filluar statusi i udhëtarit (*seferi*), ai nuk obligohet me *kefaret* (shpagim të rëndë), por vetëm me kaza, domethënë ta kompensojë atë ditë më vonë.

**Sëmundja:** Personit që, nëse agjëron, i shtohet ose i zgjatet sëmundja, si dhe atij që për shkak të sëmundjes e ka të vështirë të agjërojë, i është dhënë leje që të mos agjërojë në muajin Ramazan, me kusht që t'i kompensojë (*kaza*) ato ditë pasi të shërohet. Edhe ai për të cilin mjeku konstaton se, nëse agjëron, do të sëmuret, konsiderohet në të njëjtin status si i sëmuri.

**Pleqëria:** Personat që janë aq të moshuar sa nuk kanë më fuqi të agjërojnë, mund të mos agjërojnë dhe në vend të tij të japin *fidje*. Në ajetin 184 të sures el-Bekara në Kur'an është përcaktuar se ata që nuk kanë mundësi ta përballojnë agjërimin, duhet të japin *fidje* duke e ushqyer një të varfër. Në të njëjtin status hyjnë edhe të sëmurët për të cilët nuk ka shpresë shërimi.

**Uria ose etja në shkallë të rëndë:** Personi që, për shkak të urisë ose etjes, rrezikon dëmtim serioz të shëndetit fizik apo mendor, lejohet ta prishë agjërimin. Nëse gjendja shëndetësore përmirësohet, dita e prishur kompensohet (*kaza*) pas Ramazanit. Nëse vazhdimi i agjëritimit në një gjendje të tillë do të çonte deri në rrezik për jetën, atëherë mosprishja e agjëritimit – pra vazhdimi i tij – bëhet e ndaluar (haram).

**Puna e rëndë dhe e mundimshme:** Në parim, nuk është e drejtë që një person të punojë apo të detyrohet të punojë në punë aq të rënda sa t'ia pamundësojnë kryerjen normale të adhurimeve (ibadeteve). Megjithatë, rrethana të ndryshme personale apo shoqërore mund ta bëjnë të domosdoshme që disa njerëz të angazhohen në punë të tilla. Nëse një person në këtë gjendje druhet se, po të agjërojë, do t'i dëmtohet shëndeti, ai mund të mos agjërojë. Ata që ndodhen në një situatë të tillë duhet t'i kompensojnë (*kaza*) ditët e paagjëruara në ditët e pushimit ose në kohë të përshtatshme më vonë.

**Shtatzënia dhe gjdhënia:** Gratë shtatzëna ose ato që janë me fëmijë në gji, nëse ekziston mundësia që nga agjërimi të dëmtohen ato vetë ose fëmija, konsiderohen si ata/ato që nuk e kanë gjendjen shëndetësore të përshtatshme për të agjëruar. Në një rast të tillë, ato mund të mos agjërojnë. Madje, nëse gjasat e dëmtimit janë të mëdha, mosagjërimi bëhet i domosdoshëm. Kur gjendja e tyre të normalizohet, ato i kompensojnë (*kaza*) ditët e lëna pa agjëruar.

Fakihët (juristët islamë) kanë parapëlqyer që lehtësimi për mosagjërim të kufizohet vetëm në arsyet e përmendura në Kur'an dhe në Sunnet. Edhe pse veçoria e përbashkët e këtyre arsyeve është vështirësia (*meshakkati*), ata janë treguar të

kujdesshëm të mos pranojnë që në çdo gjendje të vështirë të lejohet mosagjërimi.

Kur shkak u që e ka bërë të lejueshëm mosagjërimin zhduket, ditët e lëna pa agjëruar kompensohen (*kaza*). Nëse ekziston një pengesë e përhershme për agjërim - si sëmundja e pashërueshme ose pleqëria e thellë - atëherë për çdo ditë të paagjëruar jepet një fidje. *Fidja* e një dite agjërimi është në masën e një *sadakaje të fitrit*. Ndërsa *sadakaja e fitrit* përbën sasinë e ushqimit që mjafton për ta ushqyer një person me mesatare për një ditë, ose vlerën e saj në para.

#### **4. A është e lejueshme që punëtorët të mos agjërojnë nga frika e rënies së rendimentit në punë?**

Ramazani është farz për çdo musliman që ka arritur moshën e pjekurisë dhe gëzon shëndet mendor. Ai që nuk agjëron pa pasur një arsye të vlefshme, kryen një mëkat të madh. I Dërguari i Allahut, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "*Nëse një person, pa pasur ndonjë lehtësim të dhënë nga Allahu, nuk e agjëron një ditë të Ramazanit, edhe sikur ta agjërojë gjithë vitin (pastaj si kompensim), nuk e zëvendëson dot atë ditë (në sevape).*" (Ebu Davudi, Saum, 38; krh. Buhariu, Saum, 29).

Ka mendime që thonë se ata që janë të detyruar të punojnë në punë shumë të rënda për ta siguruar jetesën e familjes dhe që nga agjërimi u dëmtohet shëndeti, mund të mos agjërojnë në ato ditë dhe t'i kompensojnë më vonë. Nëse nuk kanë mundësi për *kaza*, atëherë për çdo ditë japin fidje.

Megjithatë, puna e përditshme që nuk është shumë e rëndë nuk konsiderohet arsye për ta lënë agjërimin. Në Kur'an thu-

het: *“Ata janë burra që nuk i pengon as tregëtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”* (en-Nûr, 24:37).

## **5. Çfarë do të thotë *fidja* e agjërimit?**

*Fidja* është një detyrim fetar me karakter material që paguhet në rast se disa adhurime nuk kryhen, ose gjatë kryerjes së tyre bëhen disa mangësi. Në lidhje me ibadetet, *fidja* haset te agjërimi dhe te haxhi. Personi që nuk mund të agjërojë për shkak të pleqërisë ose të një sëmundjeje pa shpresë shërimi, dhe që nuk ka mundësi ta kompensojë më vonë (*kaza*), paguan një *fidje* për çdo ditë që nuk ka agjëruar. Në Kur'an thuhet: *“Ata që nuk kanë mundësi të agjërojnë, japin fidje, duke ushqyer një të varfër.”* (el-Bekara, 2:184).

Shuma e një *fidjeje* është e barabartë me masën e një sadakaje të fitrit.

Sadakaja e fitrit është sasia e ushqimit që mjafton për ta ushqyer një person për një ditë, ose vlera e saj në para. Ai që është i detyruar të japë *fidje*, por nuk ka mundësi materiale për ta bërë këtë, kërkon falje prej Allahut.

Të sëmurët ose të moshuarit që nuk mund të agjërojnë për shkak të ditëve të gjata, nëse janë në gjendje të agjërojnë në ditët e shkurtra, duhet t'i kompensojnë (*kaza*) ato ditë në periudha më të përshtatshme. Në këtë rast, *fidjet* që kanë dhënë konsiderohen sadaka (lëmoshë).

Fidja e agjërimit mund të jepet e gjitha njëherësh në fund të muajit Ramazan, por mund të jepet edhe çdo ditë gjatë Ramazanit, ose që në fillim të tij.

## **6. Kur dhe si bëhet nijeti për agjërime?**

Nijeti është një nga kushtet e agjërimit. Agjërimi pa nijet nuk është i vlefshëm. Mjafton nijeti me zemër, por shprehja e tij me gojë është e pëlqyeshme (*mendub*). Edhe ngritja në syfyr konsiderohet nijet për agjërime.

Për agjërimin e Ramazanit, për agjërimet e betuara në ditë të caktuara dhe për agjërimet vullnetare (*nafile*), koha e nijetit fillon nga perëndimi i diellit dhe vazhdon deri para se dielli të arrijë pikën më të lartë në mesditë (para zevalit). Megjithatë, që nijeti i bërë pas imsakut të jetë i vlefshëm, prej atij momenti nuk duhet të jetë ngrënë apo pirë asgjë dhe nuk duhet të jetë kryer ndonjë veprim që e prish agjërimin. Përndryshe, nijeti i bërë gjatë ditës nuk është i lejueshëm.

Për këto agjërime, mjafton një nijet i përgjithshëm, si p.sh.: “po bëj nijet të agjëroj nesër”. Megjithatë, është më e virtyshme që nijeti të bëhet natën dhe të përcaktohet: “po bëj nijet për agjërimin e ditës së nesërme”. Për çdo ditë të Ramazanit kërkohet nijet i veçantë.

Sa u përket agjërimeve kaza, kefaret dhe atyre të betuara pa një kohë të caktuar, nijeti duhet të bëhet nga perëndimi i diellit deri më së voni në kohën e imsakut. Në këto raste, gjatë nijetit duhet të përcaktohet qartë lloji i agjërimit, si p.sh.: “po bëj nijet për kaza”, “për kefaret” ose “për agjërime të betuar”.

## 7. Çfarë është imsaku? Kur fillon?

Fjala imsak, në kuptimin leksikor, do të thotë “të përmbahesh, ta ndalosh veten, të heqësh dorë, të tërhiqesh”. Si term fetar, ajo nënkupton përmbajtjen nga ngrënia, pirja, marrëdhëniet intime dhe çdo gjë tjetër që e prish agjërimin, nga *fexhr-i sadik* (agimi i vërtetë) deri në kohën e iftarit. E kundërta e imsakut është iftari.

Në përdorimin e përditshëm, fjala “imsak” përdoret për të shënuar kohën kur lind *fexhr-i sadik* dhe fillon agjërimi. Në këtë kuptim, imsak do të thotë koha e fillimit të agjërimit.

Koha e fillimit të namazit të sabahut dhe e nisjes së agjërimit, përkon me lindjen e *fexhr-i sadik*. Në Kur'an thuhet: “*Hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje.*” (el-Bekara, 2:187). Ky ajet është dëshmi se koha e imsakut fillon me shfaqjen e agimit të vërtetë (*fexhr-i sadik*).

*Fexhr-i sadik* është bardhësia horizontale që shfaqet në horizont për shkak të afrimit të lindjes së diellit. Në shqip kjo përkethehet si “zbardhja e agimit” ose “çelja e dritës së mëngjesit”.

Në ditët tona, jeta urbane e ka vështirësuar vëzhgimin e horizontit; ndriçimi i qyteteve e pengon një vrojtim të saktë, struktura e terrenit mund të mos jetë e përshtatshme, ndërsa ndotja e ajrit dhe kushtet atmosferike e bëjnë edhe më të vështirë përcaktimin e lindjes së *fexhr-i sadikut* me anë të vëzhgimit individual. Për këtë arsye, është bërë e domosdoshme përdorimi i të dhënave shkencore dhe i teknologjisë për ndjekjen dhe përcaktimin e dukurive qiellore dhe të hori-

zontit, veçanërisht të lëvizjeve të diellit, tokës dhe hënës. Edhe rendi i pagabueshëm që Allahu i Lartësuar e ka vendosur në gjithësi - siç përmendet në Kur'an (el-En'am, 6:96; Fatir, 35:13; Jasin, 36:38-40; el-Kamer, 54:49) - në thelb e nënkupton pikërisht këtë rregullsi dhe matshmëri të saktë.

Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë (Diyamet) si kriter shkencor për përcaktimin e fillimit të imsakut, e merr për bazë agimin astronomik, pra momentin kur dielli afrohet në 18° nën horizont. Sipas kësaj, fillimi i agimit të mëngjesit përcaktohet në çastin kur dielli arrin këtë kënd prej 18° nën horizont. Kriterin që kjo Kryesi e përdor për përcaktimin e kohës së imsakut - dhe rrjedhimisht për kohëzgjatjen e agjërimit - është pranuar dhe zbatohet pothuajse nga e gjithë bota islame.

## **8. A mund të vazhdohet ngrënia dhe pirja për pak kohë kur fillon ezani i sabahut?**

Kohëzgjatja e shënuar në kalendar si "imsak" tregon fillimin e agjërimit. Imsaku është njëkohësisht çasti kur mbaron nata, përfundon koha e namazit të jacisë dhe hyn koha e namazit të sabahut. Edhe ezani këndohet me hyrjen e kohës së imsakut. Prandaj, me fillimin e ezanit duhet ndërprerë ngrënia dhe pirja. Megjithatë, nuk ka pengesë që kafshata që ndodhet në gojë në momentin kur nis ezani të gëlltitet. (Në viset tona shqiptare ezani i sabahut thirret zakonisht nga 15-30 minuta pas imsakut. Prandaj, duhet të kihet kujdes që, me agjërimit të fillohet kur arrihet koha e imsakut e shënuar në kalendar ose takvim, e jo kur thirr ezani - R. Neziri)

## 9. A agjërohet në ditët e Bajramit?

Ditët e Bajramit janë ndër ditët në të cilat agjërimi është i ndaluar. Agjërimi në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në katër ditët e Bajramit të Kurbanit është *tahrimek mekruh* (ndalim i fortë afër haramit). Arsyeja pse agjërimi në këto ditë nuk është i pëlqyeshëm dhe është i ndaluar, lidhet me faktin se Bajramet janë ditë ngrënieje, pirjeje dhe gëzimi. Bajrami i Ramazanit është si një “gosti e përgjithshme iftari” pas një muaji agjërimi për hir të Allahut; për këtë kuptim është quajtur edhe “Fitr Bajrami” (Bajrami i iftarit). Dita e parë e këtij Bajrami përfaqëson iftarin e një muaji të tërë agjërimi. Të agjërosh në një ditë të tillë do të thotë të mos marrësh pjesë në gostinë simbolike që Allahu e ka caktuar, gjë që bie ndesh me frymën e saj. Edhe ditët e Bajramit të Kurbanit, kur therën kurbanet për hir të Allahut, janë ditë gostie. Muhammedi s.a.v.s. ka theksuar se ditët e *teshrikut* (10-13 Dhu'l-Hixheh) janë ditë ngrënieje, pirjeje dhe përmendjeje të Allahut (Buhariu, Saum, 66-67; Ebu Davud, Saum, 49).

## 10. Cili është statusi i agjërimin në ditën e xhuma?

Agjërimi nafile vetëm i ditës së xhuma është konsideruar *tenzihen mekruh* (i papëlqyeshëm në shkallë të lehtë). I Dërguari i Allahut, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: “*Asnjëri prej jush të mos e agjërojë vetëm ditën e xhuma. Por nëse agjëron një ditë para ose pas saj, atëherë mund ta agjërojë edhe të xhuma.*” (Ebu Davudi, Saum, 50).

Nuk ka asnjë pengesë që në ditën e xhuma të mbahet një agjërimit farz i mbetur për kaza ose një agjërimit i betuar (vaxhib). Ata që dëshirojnë të agjërojnë nafile në këtë ditë, është e përshtatshme ta shoqërojnë me një ditë para ose pas saj.

Arsyeja pse veçimi i ditës së xhuma për agjërimit është konsideruar mekruh lidhet me faktin se kjo ditë është pranuar si ditë e festës javore për muslimanët.

## **11. Cili është vendi i tre muajve në fe dhe cili është statusi i agjërimit në këta muajt?**

Në traditën popullore, muajt Rexheb, Shaban dhe Ramazan njihen si “tre muajt” dhe konsiderohen muajt të bekuar. Në të vërtetë, Muhammedi s.a.v.s., kur hynte muaji Rexheb, lutej kështu: *“O Allah! Na e beko Rexhebin dhe Shabanin dhe na mundëso ta arrijmë Ramazanin.”* (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, I, 259).

Agjërimiti në muajin Ramazan është farz (el-Bekara, 2:184-185). Sa u përket muajve Rexheb dhe Shaban, në burimet e hadithit transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. agjëronte më shumë nafile në këta muajt krahasuar me muajt e tjerë, por jashtë Ramazanit nuk e ka kaluar asnjë muajt të plotë në agjërimit (Buhariu, Saum, 52-53; Muslim, Sijam, 173-79).

Prandaj, nuk ka bazë fetare që muajt Rexheb dhe Shaban të kalohen plotësisht në agjërimit pa ndërprerje. Personi, nëse ka shëndet dhe fuqi, mund të agjërojë në këta muajt sa të dëshirojë, si agjërimit vullnetar.

## **12. A ka detyrim që agjërimet e mbetura kaza nga Ramazani të plotësohen brenda një afati të caktuar?**

Agjërimi që, për arsye të vlefshme, nuk është mund të mbahet në muajin Ramazan ose që është prishur pasi ka filluar, duhet të kompensohet, të bëhet kaza. Në Kur'an thuhet: *"E kush prej jush është i sëmurë ose në udhëtim, le t'i agjërojë (ato ditë) më vonë, aq sa ka lënë."* (el-Bekara, 2:184).

Nuk ka ndonjë dëshmi që kërkon që agjërimet kaza të mbahen patjetër njëra pas tjetrës. Megjithatë, është e përshtatshme që ato të plotësohen sa më shpejt dhe pa vonesë, sepse ky është një detyrim ndaj Allahut. Njeriu nuk e di se kur do t'i vijë vdekja.

Kompensimi (kaza) i agjërimin të Ramazanit mund të bëhet në çdo kohë, përveç ditëve në të cilat agjërimi është i ndaluar. Muhammedi s.a.v.s. ka njoftuar se në dy kohë nuk lejohet agjërimi: në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në ditët e Bajramit të Kurbanit (Buhariu, Saum, 66-67).

## **13. Nëse një person ka shumë agjërimet kaza, si duhet t'i plotësojë?**

Personi që e ka pasur detyrim agjërimin e Ramazanit dhe nuk e ka mbajtur, ose nuk ka mundur ta mbajë për shkak të një arsyeje të vlefshme, ai së pari duhet ta përcaktojë numrin e ditëve të lëna. Pastaj këto ditë i kompenzon (*kaza*) në ditë të tjera, përveç ditëve të Bajramit kur agjërimi është i ndaluar.

Për çdo ditë kaza është e përshtatshme të bëhet nijet me fjalët: "Po bëj nijet ta agjëroj ditën e parë që më ka mbetur borxh."

Sa i përket llogaritjes së agjërimeve të mbetura për kaza, mund të paraqiten dy raste:

a. Personi mund të mos ketë agjëruar asnjëherë që nga momenti kur është bërë i obliguar (*mukellef*). Në këtë rast, për çdo vit që ka kaluar që nga arritja e moshës së pjekurisë, ai duhet ta llogarisë një muaj hënor - që është njëzet e nëntë ose tridhjetë ditë; për siguri është e përshtatshme të merret si bazë tridhjetë ditë - dhe t'i plotësojë ato agjërime.

b. Personi mund të ketë lënë për kaza vetëm disa ditë pas obligimit. Në këtë rast, duhet të përpiqet sa më shumë ta llogarisë numrin e saktë të ditëve të paagjëruara dhe t'i kompensojë ato ditë për ditë.

Ata që e kanë lënë agjërimin pa arsye të vlefshme, krahas kazasë duhet të bëjnë edhe teube dhe istigfar.

#### **14. A kërkohet kaza për agjërimet vaxhib dhe nafile që prishen?**

Agjërimi që është bërë vaxhib për shkak të një betimi (*nedhr*), nëse prishet, duhet të kompensohet (*kaza*).

Agjërimi nafile është ai që mbahet me dëshirë, jashtë Ramazanit, pa qenë farz apo vaxhib për personin. Edhe pse është vullnetar, një adhurim i filluar duhet të përfundohet. Për këtë arsye, ashtu si në adhurimet e tjera nafile, sipas medh'hebit hanefi, edhe agjërimi nafile që prishet duhet të kompensohet dhe kjo konsiderohet vaxhib.

## **15. Cili është statusi i agjërimit të Shevalit?**

Pas Ramazanit, agjërimi i gjashtë ditëve në muajin Sheval është *mustehab* (i pëlqyeshëm). Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush e agjëron Ramazanin dhe pastaj ia shton atij gjashtë ditë nga Shevali, është sikur ta ketë agjëruar tërë vitin.”* (Muslimi, Sijam, 204; Tirmidhiu, Saum, 53; Ebu Davudi, Saum, 59).

Këto agjërime mund të mbahen njëra pas tjetrës ose me ndërprerje gjatë muajit.

Agjërimi nafile i mbajtur në Sheval nuk e zëvendëson agjërimitin e pa mbajtur të Ramazanit; ditët e lëna nga Ramazani duhet patjetër të kompensohen (*kaza*). Meqenëse në një agjërimit nuk është e vlefshme të bëhet njëkohësisht nijet edhe për kaza edhe për nafile, gjatë agjërimit në Sheval duhet të bëhet nijet vetëm për njërën prej tyre. Nëse gjatë muajit Sheval bëhet nijet për kaza të agjërimeve të Ramazanit, atëherë ato konsiderohen agjërime kaza.

## **16. Cili është statusi i agjërimit në ditën e Ashures?**

Dita e dhjetë e muajit Muharrem quhet Dita e Ashures. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: *“Shpresoj që agjërimi i ditës së Ashures të jetë shlyerje për mëkatet e vitit të kaluar.”* (Tirmidhiu, Saum, 47), duke e rekomanduar kështu agjërimitin në këtë ditë.

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., hebrenjtë e agjëronin vetëm ditën e dhjetë të Muharremit. Për të mos u përngarë atyre,

është e përshtatshme që kësaj dite t'i shtohet edhe një ditë para ose një ditë pas saj.

### **17. A agjërohet për ta pritur Ramazanin?**

Dihet se Muhammedi s.a.v.s. në muajt Rexheb dhe Shaban agjëronte më shumë nafiie krahasuar me muajt e tjerë (Buhariu, Saum, 52; Muslimi, Sijam, 173-179). Megjithatë, kjo praktikë e tij nuk duhet të interpretohet si agjërim për ta “pritur” Ramazanin. Agjërimi me qëllim për ta pritur Ramazanin nuk ka bazë fetare.

Po ashtu, është mekruh të agjërohet një ose dy ditë para Ramazanit me mendimin se ndoshta Ramazani ka hyrë. Në terminologjinë fetare kjo ditë quhet “dita e dyshimit” (*jeumu'sh-shekk*).

Megjithatë, nëse në ditën e dyshimit agjërohet pa qëllim për ta pritur Ramazanin, nuk ka pengesë. Në të vërtetë, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: “*Mos e pritni Ramazanin me agjërim një ose dy ditë para tij. Por nëse dikush ka zakon t'i agjërojë këto ditë, le t'i agjërojë.*” (Buhariu, Saum, 14; Muslimi, Sijam, 21).

### **18. Si mund ta përmbushë agjërimin personi që, për shkak të profesionit, udhëton vazhdimisht?**

Sa kohë që vazhdon arsyeja e vlefshme, vazhdon edhe lehtësimi. Prandaj, personat që nuk mund të agjërojnë për shkak të udhëtimit ose sëmundjes, mund të mos agjërojnë për aq kohë sa zgjat kjo arsye.

Personat që kanë një arsye të vazhdueshme, kur ajo të pushojë, i kompensojnë (*kaza*) agjërimet e Ramazanit që nuk i kanë mbajtur në kohën e tyre.

Në Kur'an thuhet: *"... E kush është i sëmurë ose në udhëtim, le t'i agjërojë (ato ditë) më vonë, aq sa ka lënë."* (el-Bekara, 2 :185).

Edhe kapitenët dhe drejtuesit e mjeteve që udhëtojnë vazhdimisht në distanca të gjata konsiderohen në gjendje udhëtimi. Megjithatë, për ata që gjatë udhëtimit nuk përjetojnë vështirësi, është më e virtytshme të agjërojnë.

## **19. Personi që udhëton me avion, sipas cilit vend e bën iftarin?**

Personat që udhëtojnë duhet ta bëjnë imsakun dhe iftarin sipas vendit ku ndodhen në atë moment. Edhe ata që udhëtojnë me avion, gjatë fluturimit duhet ta bëjnë imsakun dhe iftarin sipas vendndodhjes së avionit.

Megjithatë, në udhëtimet ndërkontinentale me avionë shumë të shpejtë, koha ndërmjet imsakut dhe iftarit mund të jetë jashtëzakonisht e shkurtër ose tepër e gjatë. Në këtë rast, personi që do të udhëtojë mund ta lërë agjërimin për *kaza*. Por nëse e ka filluar agjërimin, mund ta bëjë iftarin sipas një vlerësimi të arsyeshëm (p.sh., sipas kohës së akshamit të vendit ku e ka nisur agjërimin).

## **20. Nëse gjatë abdesit, pa dashje, i shkon ujë në fyt agjëruesit, a i prishet agjërimi?**

Prishja e agjërimit me gabim, pa dashje, është kur veprimi që e prish agjërimin ndodh pa qëllim për ta prishur atë, si p.sh., kur gjatë abdesit, duke shpëlarë gojën, pa dashje i shkon ujë në fyt.

Kryerja e një veprimi që e prish agjërimin në mënyrë të pavullnetshme e prish agjërimin dhe kërkon vetëm kaza.

Megjithatë, nëse uji i ka shkuar në fyt në një moment kur personi nuk e ka pasur ndërmend se ishte agjërueshëm - pra duke harruar se ishte në agjërime - atëherë kjo e merr gjykimin (statusin) e veprimit të bërë nga harresa dhe agjërimi nuk prishet.

Një sahabi e pyeti Muhammedin s.a.v.s.: *“O i Dërguari i Allahut! Hëngra e piva nga harresa duke qenë agjërueshëm. A m'u prish agjërimi?”* Ai s.a.v.s. iu përgjigj: *“(Jo, nuk u prish.) Allahu të ushqeu dhe të dha të pish.”* (Ebu Davudi, Saum, 39).

## **21. A e prish agjërimit larja ose hyrja në det?**

Për sa kohë që uji nuk hyn nga goja ose hunda dhe nuk arrin në organet e tretjes, larja e trupit nuk e dëmton agjërimit e personit që është agjërueshëm. Për më tepër, hz. Aisheja dhe Ummu Seleme kanë transmetuar se Muhammedi s.a.v.s. në Ramazan lahej edhe pas imsakut (Buhariu, Saum, 25).

Prandaj, personi që agjëron mund të lahet dhe mund të hyjë edhe në det, me kusht që të mos i hyjë ujë në stomak përmes gojës ose hundës. Megjithatë, ai që hyn në det mund të gëllti-

së ujë për shkak të dallgëve ose gjatë notit. Për këtë arsye, është më e kujdesshme që gjatë agjërimit të shmanget hyrja në det.

## **22. A është i vlefshëm agjërimi kur njeriu është xhunub?**

Të qenit xhunub nuk është pengesë për agjërimin. Nuk ka dallim nëse gjendja që kërkon gusël ka ndodhur para fillimit të agjërimit, apo gjatë agjërimit për një arsye që nuk e prish atë (si p.sh. ëndrra e lagësht – *ihtilami*).

Megjithatë, personi që është xhunub duhet të lahet sa më shpejt dhe të pastrohet. Nuk duhet t'i kalojë një kohë namazi ndërkohë që është ende xhunub. Shtyrja e guslit përtej kohës së një namazi është mëkat, sepse nëse vonohet, namazi mbetet pa u falur në kohën e tij.

## **23. Çfarë është sadakaja e fitrit dhe kur jepet?**

Sadakaja e fitrit (e njohur në popull si “fitre”) është një lëmoshë që muslimani, i cili konsiderohet i pasur sipas kriterëve fetare dhe që e arrin fundin e muajit Ramazan, është i detyruar (*vaxhib*) ta japë për persona të caktuar, si shenjë falënderimi për krijimin si njeri dhe për arritjen e Bajramit pas agjërimit të Ramazanit. Vaxhibi i saj është i bazuar në Sunet (Buhariu, Zekat, 70-78; Muslimi, Zekat, 12-16; Ebu Davudi, Zekat, 18; Ibnu Maxhe, Zekat, 21).

Personi është i obliguar të japë fitren për veten dhe për fëmijët e tij të mitur.

Koha kur fitra bëhet vaxhib është dita e parë e Bajramit të Ramazanit; megjithatë, ajo mund të jepet edhe para Bajramit, madje kjo është më e virtytshme. Mund të jepet edhe në ditën e Bajramit ose pas tij, por është mustehab të jepet para namazit të Bajramit. Lejohet gjithashtu që fitra të jepet që në ditët e para të Ramazanit.

Qëllimi i fitres është të sigurojë për një të varfër ushqimin e një dite sipas standardit jetësor të shoqërisë ku jeton, në mënyrë që ai të mund të marrë pjesë në gëzimin e Bajramit. Në kohët tona, është më e përshtatshme që si masë të merret sasia që mbulon nevojën normale ushqimore të një dite (dy vakte).

#### **24. Kujt mund t'i jepet sadakaja e fitrit dhe kujt nuk mund t'i jepet?**

Sadakaja e fitrit u jepet muslimanëve të varfër, për të cilët personi nuk ka detyrim përkujdesjeje.

Një person nuk mund t'ua japë zekatin, fitren apo fidjen atyre që quhen "usul" dhe "furu". (Me "usul" nënkuptohen: nëna, babai, gjyshi dhe gjyshja; me "furu" nënkuptohen: fëmijët, nipërit/mbesat dhe pasardhësit e tyre.)

Po ashtu, bashkëshortët nuk mund t'i japin njëri-tjetrit zekat, fitre apo fidje.

Sipas medh'hebit hanefi, fitra nuk u jepet:

- a) Nënës, babait, gjyshes dhe gjyshit,
- b) Djalit, fëmijëve të djalit, vajzës, fëmijëve të vajzës dhe pasardhësve të tyre,

- c) Bashkëshortit/bashkëshortes,
- d) Personit të pasur, pra atij që përveç nevojave themelore zotëron pasuri në masën e nisabit,
- e) Fëmijës të mitur, babai i të cilit është i pasur.

Përveç këtyre, të afërmve si vëllai, motra, teza, daja, xhaxhai, halla dhe fëmijët e tyre, nusja, dhëndri, vjehri dhe vjehrra - nëse nuk janë të pasur - mund t'u jepen zekat, fitre dhe fidje.

## **25. Si paguhet fidja e agjërimit?**

Shuma e fidjes së agjërimit është e barabartë me sadakanë e fitrit.

Kjo fidje mund të jepet në fillim të Ramazanit, gjatë tij ose në fund të muajit. E gjithë shuma mund t'i jepet një të varfri të vetëm, ose mund të ndahet dhe t'u jepet disa të varfërve.

Personat që janë në këtë gjendje, nëse nuk kanë mundësi ta japin fidjen, kërkojnë falje prej Allahut Mëshirëplotë.

Të moshuarit që nuk kanë fuqi të agjërojnë dhe të sëmurët pa shpresë shërimi, nëse më vonë bëhen të aftë për të agjësuar, sipas medh'hebit hanefi duhet t'i kompensojnë (*kaza*) ditët e paagjësuar, edhe nëse e kanë dhënë më parë fidjen. Në këtë rast, fidjet e dhëna konsiderohen si sadaka (lëmshë) nafile.

## **26. Kujt mund t'i jepet fidja e agjërimit?**

Fidja e agjërimit, ashtu si sadakaja e fitrit, u jepet muslimanëve të varfër për të cilët personi nuk ka detyrim përkuqdesjeje.

(Për hollësi më të gjera, shih pyetjen nr. 24: “Kujt mund t’i jepet sadakaja e fitrit dhe kujt nuk mund t’i jepet?”)

## **27. A lirohet nga borxhi i agjërimit duke dhënë fidje ai që ka pasur fuqi të agjërojë, por nuk ka agjëruar?**

Dhënia e fidjes për agjërimit vlen vetëm për të moshuarit që nuk kanë fuqi të agjërojnë dhe për të sëmurët pa shpresë shërimi. Praktika e Muhammedit s.a.v.s. dhe e sahabëve tregojnë se shprehja në Kur'an “ata që e kanë të vështirë të agjërojnë” (el-Bekara, 2:184) i përfshin vetëm këta persona.

Prandaj, për ata që kanë pasur mundësi të agjërojnë, por nuk kanë agjëruar, ose që nuk kanë agjëruar për një arsye të përkohshme, nuk vlen dispozita e fidjes. Ata që nuk kanë agjëruar pa arsye të vlefshme duhet t’i kompensojnë (*kaza*) ditët e lëna dhe të bëjnë *teube* (pendim) e *istigfar* (kërkim-falje).

Po ashtu, nëse të moshuarit që nuk kanë pasur fuqi për agjërimit ose të sëmurët pa shpresë shërimi, më vonë bëhen të aftë për të agjëruar, sipas medh’hebit hanefi duhet t’i kompensojnë ditët e paagjëruara, edhe nëse e kanë dhënë fidjen më parë. Fidjet e dhëna më herët nuk e shlyejnë borxhin e agjërimit.

### **III. GJËRAT QË E PRISHIN DHE ATO QË NUK E PRISHIN AGJËRIMIN**

#### **28. Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin?**

Meqenëse elementi themelor i agjërimit është përmbajtja nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime, si dhe privimi i vetes prej këtyre, atëherë gjatë agjërimit këto dhe çdo veprim që e merr kuptimin e tyre e prishin agjërimin.

Ngrënia dhe pirja përfshijnë çdo gjë që hahet dhe pihet zakonisht. Në këtë kuadër hyjnë edhe substancat që thithen nëpërmjet tymit, si cigaret dhe nargjilja, si dhe lëndët narkotike dhe çdo substancë që merret për shkak të një dhënieje pas tyre. Po ashtu, barnat që merren nga goja, pavarësisht nga arsyeja, i nënshtrohen të njëjtit gjykim.

#### **29. Cilat janë rastet që e prishin agjërimin dhe kërkojnë vetëm kaza?**

Agjërimi që priset për shkak të një arsyeje të ligjshme, si udhëtimi apo sëmundja, kërkon vetëm kaza.

Po ashtu, ngrënia ose pirja pa qëllim - si p.sh. kur gjatë abdesit i shkon ujë në fyt - e prish agjërimin dhe kërkon vetëm kaza. Edhe ngrënia ose pirja e gjërave që zakonisht nuk konsumohen për ushqim dhe nuk kanë qëllim ushqyes, si p.sh. orizi i papjekur ose toka, gjëra që natyra njerëzore nuk i dëshiron, e prish agjërimin dhe kërkon vetëm kaza.

Agjërimet e Ramazanit që nuk mbahen pa ndonjë arsye të vlefshme duhet të kompensohen ditë për ditë. Megjithatë, lënia e agjërimin të Ramazanit pa arsye është mëkat i madh.

Veprime të tjera që e prishin agjërimin dhe kërkojnë vetëm kaza janë: kënaqja (derdhja) jashtë marrëdhënies seksuale, gëlltitja pa dashje e shiut, borës ose breshrit që hyn në gojë, gëlltitja pa dashje e ujit gjatë abdesit, larjes apo notit, si dhe vjellja e qëllimshme me gojën plot.

Nëse një person ka dyshim nëse ka hyrë apo jo koha e imsakut dhe vazhdon të hajë e të pijë, por më pas del se fexhri i dytë (agimi i vërtetë) ka lindur tashmë, agjërimi priset dhe duhet të bëhet kaza. Po ashtu, nëse dikush bën iftar me mendimin se dielli ka perënduar, por më vonë kuptohet se dielli ende nuk kishte perënduar, atëherë kërkohet kaza.

Nëse pas ngrënies ose pirjes nga harresa, personi mendon gabimisht se agjërimi i është prishur dhe për këtë arsye vazhdon me vetëdije të hajë, të pijë ose të kryejë marrëdhënie intime, agjërimi priset dhe kërkohet kaza. Po kështu, nëse nuk e ka bërë nijet natën, por e ka bërë gjatë ditës, dhe më pas mendon gabimisht se ky nijet nuk është i vlefshëm, e për këtë arsye gjatë pjesës së mbetur të ditës ha, pi ose kryen marrëdhënie intime me vetëdije, agjërimi priset dhe duhet të kompensohet (*kaza*).

### **30. Nëse një person gjatë Ramazanit niset për udhëtim dhe e prish agjërimin për shkak të udhëtimit, çfarë kërkohet?**

Personi që gjatë Ramazanit niset për një udhëtim në distancë *seferije* (të paktën 90 km), mund të mos bëjë nijet për agjërim që nga nata.

Megjithatë, nëse e ka bërë nijetin dhe pastaj gjatë ditës niset për udhëtim, nëse gjatë këtij udhëtimit nuk ka ndonjë arsye tjetër të vlefshme, nuk duhet ta prishë agjërimin. Një ibadet i filluar duhet të përfundohet, nëse nuk ekziston ndonjë arsye e vlefshme që ia lejon këtë.

Duek qenë se udhëtimi është një arsye e vlefshme, nëse ai e prish agjërimin pasi ka filluar statusi i udhëtarit (*seferi*), nuk kërkohet *kefare*t, por vetëm *kaza*.

### **31. Cili është gjykimi i prishjes së qëllimshme të agjërimin?**

Prishja e qëllimshme e agjërimin, pra kur një person pa pasur arsye të vlefshme e prish me vetëdije, është mungesë respekti ndaj shenjtërisë së Ramazanit dhe përbën mëkat të madh.

Muhammedi s.a.v.s. ka theksuar se ata që e prishin agjërimin në këtë mënyrë janë të obliguar me *kefare*t (Buhariu, Saum, 30; Muslimi, Sijam, 81).

*Kefareti* i agjërimin është të agjërohen dy muaj hënorë radhazi, pra 60 ditë pa ndërprerje. Ai që nuk ka mundësi për këtë, duhet të ushqejë 60 të varfër për një ditë, ose një të varfër për 60 ditë.

Përveç kefaretit, kërkohet edhe teube, si dhe kompensimi (*kaza*) i ditës së prishur.

### **32. A e prish agjërimin ngrënia dhe pirja nga harresa?**

Ngrënia dhe pirja nga harresa nuk e prishin agjërimin. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: *“Nëse dikush, duke harruar se është agjërueshëm, ha ose pi, le ta plotësojë agjërimin e tij dhe të mos e prishë. Sepse Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë.”* (Buhariu, Saum, 26).

Personi që ha ose pi nga harresa, sapo t’i kujtohet se është agjërueshëm, duhet menjëherë t’i nxjerrë nga goja ato që ka dhe ta shpëlajë gojën, pastaj të vazhdojë agjërimin.

Nëse pas kujtimit se është agjërueshëm diçka zbret në stomak, atëherë agjërimi priset (dhe duhet vetëm një ditë kaza – R. Neziri).

### **33. A e prish agjërimin larja e dhëmbëve?**

Ashtu si shpëlarja e gojës me ujë pa i shkuar ujë në fyt nuk e prish agjërimin, edhe larja e dhëmbëve nuk e prish atë.

Megjithatë, nëse pasta e dhëmbëve ose uji shkon në fyt, agjërimi priset.

Duke marrë parasysh mundësinë e prishjes së agjërimin, është e përshtatshme që dhëmbët të lahen para imsakut dhe pas iftarit. Nëse lahen gjatë agjërimin, është më mirë të mos përdoret pastë.

### **34. A e prish agjërimin vjellja?**

Vjellja që ndodh vetvetiu, pavarësisht sasisë, nuk e prish agjërimin. Po ashtu, nëse diçka ngrihet papritur nga stomaku në gojë dhe pastaj kthehet sërish në stomak, kjo nuk e dëmton agjërimin.

Por nëse personi vjell me dëshirën e vet dhe me gojën plot, agjërimi prishet. Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: *“Nëse agjëruesi vjell pa dashje dhe nuk mund ta kontrollojë veten, nuk ka nevojë për kaza. Por kush vjell me dëshirën e vet, le ta kompensojë agjërimin.”* (Ebu Davudi, Saum, 32; Tirmidhiu, Saum, 25).

Megjithatë, nëse dikush mendon gabimisht se agjërimi i është prishur për shkak të vjelljes dhe për këtë arsye vazhdon të hajë ose të pijë, atëherë agjërimi i prishet. Në këtë rast nuk kërkohet kefare, por vetëm kaza për atë ditë.

## **IV. PROBLEMET SHËNDETËSORE DHE AGJËRIMI**

Me zhvillimin e mjekësisë, në ditët tona janë shfaqur shumë metoda të reja ekzaminimi dhe trajtimi. Disa prej tyre e prishin agjërimin, ndërsa disa të tjera nuk e prishin.

Pyetjet kryesore lidhur me këto metoda dhe përgjigjet përkatëse janë si vijon:

### **35. Çfarë duhet të bëjë personi të cilit një mjek specialist i rekomandon të mos agjërojë?**

Personi për të cilin një mjek specialist konstaton se agjërimi do të ishte i dëmshëm për shëndetin e tij, mund të mos agjërojë në Ramazan.

Nëse sëmundja është e përkohshme, ai i kompenson (*kaza*) ditët e lëna pasi të shërohet.

Nëse sëmundja është e përhershme, për ditët që nuk mund t'i agjërojë ai jep *fidje* (shiko pyetjen nr. 5).

Ata që nuk kanë mundësi materiale për të dhënë fidje, nuk mbajnë përgjegjësi fetare derisa ta gjejnë këtë mundësi.

### **36. Cila është përgjegjësia e agjërimit për personat që janë në grup rreziku për sa i përket sëmundjes?**

Agjërimi i Ramazanit është farz për çdo musliman *mukel-lef* (që i plotëson kushtet – shiko pyetjen nr. 1). Lënia e këtij agjërimit pa arsye të vlefshme është një prej mëkateve të mëdha.

Në Kur'an, ndër arsyet që e bëjnë të lejueshëm mosagjërimitin përmendet edhe sëmundja. Ajeti 184 i sures el-Bekara lejon që në rast sëmundjeje agjërimit të shtyhet dhe të kompensohet (kaza) në ditë të tjera kur personi ta ketë rifituar shëndetin; ndërsa nëse bëhet i paaftë plotësisht për të agjëruar, duhet të japë fidje për ditët e lëna.

Dijetarët islamë kanë theksuar se në këtë kategori hyn edhe rasti kur ekziston rreziku që personi të sëmuret, ose që sëmundja t'i përkeqësohet apo t'i zgjatet, nëse agjëron; në këto raste lejohet shtyrja e agjërimit. Prandaj, edhe ai për të cilin mjeku konstaton se do të sëmuret po të agjërojë, konsiderohet në gjendje sëmundjeje.

Në këtë kuptim, sahabiu fakih Abdullah ibn Omer (r.a.) është shprehur se gratë shtatzëna që kanë frikë për shëndetin e tyre ose të foshnjës mund të mos agjërojnë (Muvatta, Sijam, 52).

Sipas kësaj, personi për të cilin mjeku konstaton se, nëse agjëron, ka rrezik të lartë për t'u ekspozuar ndaj sëmundjeve ngjitëse, mund ta lërë agjërimitin për kaza.

Sepse Allahu i Lartësuar ka thënë në vazhdim të ajeteve të agjërimit: *“Allahu dëshiron për ju lehtësi dhe nuk dëshiron vështirësi.”* (el-Bekara, 2:185), dhe në një ajet tjetër ka sqaruar

ar se njerëzit ngarkohen me përgjegjësi vetëm sipas mundësisë së tyre (el-Bekara, 2:286).

### **37. A e prish agjërimin spreji dhe ilaçi që përdorin të sëmurët me astmë?**

I sëmuri me astmë që është i detyruar të përdorë sprej për hapjen e frymëmarrjes mund të mos agjërojë. Më pas, nëse shërohet, i kompenson (kaza) ditët e lëna. Nëse nuk ka më shpresë shërimi, atëherë jep fidje për aq ditë sa nuk ka agjëruar. Një fidje është në masën e një fitreje për një person në Ramazan.

Megjithatë, personat me astmë që nuk kanë problem tjetër shëndetësor përveç vështirësisë në frymëmarrje, mund të agjërojnë duke përdorur sprej të posaçëm që e lehtëson frymëmarrjen. Këto spreje të spërkatura në gojë nuk e prishin agjërimin. Sepse nga një përdorim i tillë në gojë futet një sasi shumë e vogël (rreth 1/20 ml). Një pjesë e konsiderueshme e kësaj sasi përthithet nga muret e gojës dhe të rrugëve të frymëmarrjes dhe zhduket. Për sasinë që mund të arrijë në stomak përmes pështymës nuk ka informacion të sigurt.

Kur krahasohet me sasinë e ujit që mbetet në gojë gjatë abdesit, kjo sasi është shumë më e vogël. Ekzistojnë hadithe që tregojnë se, nëse gjatë abdesit një pjesë e ujit që mbetet në gojë arrin në stomak, agjërimi nuk prishet (Darimiu, es-Sunen, Saum, 16). Për këtë çështje është arritur edhe *ixhma* (konsensus).

Për më tepër, gjatë përdorimit të misvakut është e pashmangshme që disa grimca ose substanca kimike të arrijnë në stomak. Megjithatë, në burimet e sakta të hadithit transmetohet se Muhammedi s.a.v.s. e përdorte misvakun edhe duke qenë agjërueshëm (Buhariu, Saum, 27; Tirmidhiu, Saum, 29).

Nga ana tjetër, sipas parimit juridik “ajo që është e sigurt nuk priset me dyshim”, agjërimi nuk priset nga një dyshim nëse diçka ka arritur apo jo në stomak.

Prandaj, ilaçi me oksigjen që spërkatet në gojë për t’u mundësuar të sëmureve me astmë frymëmarrje më të lehtë, nuk e prish agjërimin.

### **38. A e prishin agjërimin pikat në sy?**

Sipas të dhënave të marra nga specialistët e fushës, ilaçi që hidhet në sy është në sasi shumë të vogël (rreth 50 mikrolitra, pra 1/20 e një mililitri). Një pjesë e tij del jashtë me mbylljen e syrit, ndërsa një pjesë përthithet nga indi i syrit, nga kanalet që e lidhin syrin me zgavrën e hundës dhe nga mukozat, përmes poreve, duke hyrë në trup.

Për më tepër, ky veprim nuk përbën ngrënie apo pirje, pra nuk ka kuptim ushqyes.

Prandaj, pika e syrit nuk e prish agjërimin.

### **39. A e prishin agjërimin pikat në hundë?**

Ilaçi që hidhet në hundë për qëllime trajtimi ka një sasi rreth 0,06 cm<sup>3</sup> për një pikë. Një pjesë e kësaj sasive përthithet nga

muret e hundës, ndërsa një pjesë shumë e vogël mund të arrijë në stomak.

Kjo sasi nuk është konsideruar në nivel që e prish agjërimin, ashtu si lagështia që mbetet në gojë pas shpëlarjes me ujë (*madmada*). Për më tepër, ky veprim nuk ka kuptim ngrënieje apo ushqimi.

Prandaj, pikat që spërkaten në hundë nuk e prishin agjërimin.

#### **40. A e prishin agjërimin pikat në vesh?**

Midis veshit dhe fytit ekziston një kanal. Megjithatë, daullja e veshit (membrana e timpanit) e mbyll këtë kanal, prandaj ilaçi nuk arrin në fyt. Për këtë arsye, pika e hedhur në vesh nuk e prish agjërimin.

Edhe në rast se daullja e veshit është e dëmtuar, ilaçi i hedhur në vesh përthithet brenda tij; ose nuk arrin fare në stomak, ose arrin në sasi shumë të vogël.

Për më tepër, ky veprim nuk përbën ngrënie apo pirje, pra nuk ka kuptim ushqyes.

Prandaj, pikat në vesh nuk e prishin agjërimin.

#### **41. A e prish agjërimin larja e veshit?**

Midis veshit dhe fytit ekziston një kanal, por daullja e veshit e mbyll atë, prandaj uji nuk arrin në fyt. Për këtë arsye, larja e veshit nuk e prish agjërimin.

Megjithatë, nëse daullja e veshit është e dëmtuar (e shpuar), gjatë larjes së veshit ekziston mundësia që uji të arrijë në stomak. Në këtë rast, nëse uji arrin në stomak, agjërimi prishet.

#### **42. A e prish agjërimin tableta nën gjuhë që e përdorin të sëmurët nga zemra?**

Në disa sëmundje të zemrës, tableta që vendoset nën gjuhë përthithet drejtpërdrejt nga indi i gojës dhe përzihet me gjakun, duke e parandaluar kështu krizën kardiake.

Meqenëse kjo tabletë përthithet brenda gojës dhe zhduket pa arritur asgjë në stomak, përdorimi i saj nuk e prish agjërimin.

#### **43. A duhet të agjërojnë personat që janë të detyruar të përdorin çdo ditë barna në formë tabletash?**

Sëmundja është ndër arsyet që e bëjnë të lejueshëm mosagjërimin në Ramazan. Nëse është e vërtetuar nga ana mjekësore ose nga përvoja se agjërimi do ta sëmurë personin ose do t'ia përkeqësojë sëmundjen, ai mund të mos agjërojë. Kur të përmirësohet, duhet të kompensojë (kaza) vetëm aq ditë sa ka lënë pa agjëruar në Ramazan.

Në Kur'an thuhet: *“E kush prej jush është i sëmurë ose në udhëtim, le t'i agjërojë (ato ditë) më vonë, aq sa ka lënë.”* (el-Bekara, 2:184).

Ata që janë në këtë gjendje gjatë gjithë jetës, pra me sëmundje të përhershme, japin një fidje për çdo ditë. Ndërsa personat e varfër dhe në nevojë nuk janë të detyruar të japin

fidje, sepse në fenë tonë askush nuk ngarkohet me përgjegjësi përtej mundësisë së tij.

#### **44. A e prish agjërimin endoskopia, kolonoskopia ose ekografia nga anusi apo vagina?**

Në endoskopi, që bëhet për ta vizualizuar stomakun ose për të marrë mostër nga ai, një pajisje mjekësore futet në stomak përmes gojës dhe hiqet pasi përfundon procedura.

Në kolonoskopi, që kryhet për t'i vizualizuar zorrët ose për të marrë mostër, pajisja futet përmes anusit në zorrë dhe hiqet pas përfundimit të procedurës.

Gjatë kolonoskopisë, dhe shpesh edhe gjatë endoskopisë, për pastrimin e zonës që do të ekzaminohet zakonisht jepet ujë përmes pajisjes.

Edhe pse endoskopia, kolonoskopia apo ekografia nga anusi ose vagina nuk përbëjnë ngrënie apo pirje, për shkak se zakonisht gjatë procedurës jepet ujë përmes pajisjes, agjërimi prishet.

Megjithatë, nëse gjatë përdorimit të pajisjeve nuk futet në sistemin tretës ujë, vaj apo ndonjë substancë me veti ushqyese, atëherë kryerja e endoskopisë, kolonoskopisë ose ekografisë nga anusi apo vagina nuk e prish agjërimin.

#### **45. A e prish agjërimin kryerja e biopsisë?**

Marrja e një mostre (biopsi) nga cilido organ i trupit për qëllime analizash nuk e prish agjërimin.

#### **46. A e prish agjërimin vizualizimi i kanalit urinar ose futja e ilaçit në të?**

Pajisjet që futen në kanalet urinare ose ilaçet që aplikohen në to nuk e prishin agjërimin.

#### **47. A e prish agjërimin anestezia?**

Anestezia realizohet duke dhënë ilaç në trup përmes rrugëve të frymëmarrjes ose me injeksion. Anestezia e bërë në këtë mënyrë nuk arrin në stomak dhe nuk përbën ngrënie apo pirje.

Megjithatë, në anestezinë rajonale dhe të përgjithshme, në raste urgjente hapet rrugë intravenoze dhe gjatë procedurës zakonisht jepet serum (infuzion) përmes saj.

Prandaj, anestezia lokale (mpirje e kufizuar) nuk e cenon vlefshmërinë e agjërimin. Ndërsa në anestezinë rajonale dhe të përgjithshme, për shkak të dhënies së sinfuzionit, agjërimi prishet.

#### **48. A e prish agjërimin përdorimi i supozitorëve (fitilëve) dhe bërja e klizmës?**

Procesi i tretjes përfundon në zorrët e holla. Në zorrët e trasha përthithen vetëm uji, glukozja dhe disa kripëra. Ndërsa midis vaginës së gruas dhe sistemit tretës nuk ekziston ndonjë lidhje. Prandaj, supozitorët që përdoren përmes vaginës nuk e prishin agjërimin.

Supozitorët që përdoren nga anusi, edhe pse hyjnë në sistemin tretës, nuk e prishin agjërimin, sepse tretja përfundon

në zorrët e holla, supozitorët nuk kanë veti ushqyese dhe përdorimi i tyre nuk përbën ngrënie apo pirje.

Sa i përket klizmës, paraqiten dy raste:

– Meqenëse në zorrët e trasha përthithen uji, glukozja dhe disa kripëra, nëse jepet në zorrë një lëng me përmbajtje ushqyese ose nëse uji i dhënë lihet aq sa të përthithet në sasi që e prish agjërimin, atëherë agjërimi priset.

– Por nëse uji që jepet në zorrë nuk lihet të qëndrojë dhe zorrët pastrohen menjëherë, duke nxjerrë jashtë jashtëqitjen së bashku me ujin e dhënë, dhe sasia e përthithur është shumë e vogël, atëherë agjërimi nuk priset.

#### **49. A e prish agjërimin vaksina ose injeksioni?**

Agjërimi priset me ngrënie, pirje, marrëdhënie intime dhe me gjëra që hyjnë në këtë kuptim. Prandaj, vaksinat që nuk kanë vlerë ushqyese nuk e prishin agjërimin.

Personat që janë në trajtim mjekësor mund ta shtyjnë agjërimin derisa të shërohen dhe të përfundojë trajtimi i tyre. Megjithatë, nëse dëshirojnë të agjërojnë në Ramazan së bashku me të tjerët dhe nuk kanë pengesë tjetër, është e përshatshme që injeksionet t'i marrin pas iftarit.

Ata që nuk e kanë këtë mundësi, mund të marrin injeksione për qëllime trajtimi ose vaksinimi edhe gjatë agjërimit.

Por ata që gjatë agjërimit marrin injeksione ushqyese ose vitamina, ose vaksina nga goja, apo u jepet serum ose gjak në venë, agjërimi u priset. Më pas këto ditë duhet të kompensohen (kaza).

## **50. A e prish agjërimin injeksioni i insulinës që e përdorin të sëmurët me diabet?**

Nëse një injeksion e prish apo jo agjërimin, varet nga qëllimi i përdorimit të tij. Injeksionet mund të bëhen për qetësimin e dhimbjes, për trajtim, për rritjen e rezistencës së trupit ose për ushqim.

Injeksionet që nuk kanë veti ushqyese dhe që nuk japin kënaqësi, nuk konsiderohen ngrënie apo pirje, prandaj nuk e prishin agjërimin. Ndërsa injeksionet ushqyese dhe/ose ato që japin kënaqësi e prishin agjërimin.

Meqenëse injeksioni i insulinës që përdorin të sëmurët me diabet nuk ka karakter ushqyes, ai nuk e prish agjërimin.

Nga ana tjetër, nëse mjekët specialistë konstatojnë se agjërimi do të ishte i dëmshëm për shëndetin e pacientit, ai mund të mos agjërojë në Ramazan. Nëse ekziston mundësia e shërimit, ai i kompenson (kaza) më vonë ditët e lëna; nëse nuk ka mundësi shërimi, për çdo ditë të Ramazanit jep një fidje.

Edhe pacientët që varen nga insulina, nëse agjërimi ua dëmton shëndetin, mund të mos agjërojnë. Për çdo ditë të paagjëruar japin nga një fidje.

## **51. A e prish agjërimin dhënia e gjakut ose marrja e gjakut gjatë agjërimit?**

Dhënia e gjakut gjatë Ramazanit, kur personi është agjërueshëm, nuk e prish agjërimin.

Ndërsa marrja e gjakut në trup (transfuzioni), meqenëse hyn në kuptimin e ushqimit dhe furnizimit të trupit, e prish agjërimin.

## **52. A prishet agjërimi gjatë dializës?**

Gjatë procedurës së dializës për pacientët me pamjaftueshmëri të veshkave, nëse përmes venës jepet lëng me përmbajtje ushqyese, agjërimi prishet.

Nëse nuk jepet lëng me përmbajtje ushqyese, agjërimi nuk prishet.

## **53. A e prish agjërimit kryerja e angiografisë?**

Procedura e njohur në popull si “anzhio” zbatohet për qëllime diagnostikuese dhe terapeutike. Angiografia nënkupton vizualizimin e enëve të gjakut. Në enë jepet një substancë e quajtur kontrast, e cila i bën ato të dukshme dhe më pas merren pamje të quajtura angiograme.

Falë angiografisë, vizualizohen enët që i ushqejnë organet dhe merren të dhëna për diagnostikimin e sëmundjeve të enëve ose të organeve që ushqehen prej tyre. Për qëllime trajtimi, metoda klasike quhet angioplastikë, me të cilën enët e ngushtuara ose të bllokuara hapen me anë të balonit ose stentit.

Duke u bazuar në këto të dhëna, si angiografia ashtu edhe angioplastika nuk përbëjnë ngrënie apo pirje; prandaj, nuk e prishin agjërimit.

#### **54. A e prish agjërimin trajtimi me akupunkturë?**

Akupunktura është metodë trajtimi që realizohet duke futur gjilpëra në pika të caktuara të trupit për shërimin e sëmundjeve të ndryshme.

Meqenëse nuk hyn në kuadrin e gjërave që e prishin agjërimin dhe nuk ka funksion ushqyes apo furnizues për trupin, kryerja e akupunkturës nuk e prish agjërimin.

#### **55. A e prish agjërimin përdorimi i pomadave dhe fashave me ilaç?**

Përmes poreve të lëkurës dhe kapilarëve nën të, vaji, pomadat dhe substanca të ngjashme që aplikohen në trup përthithen dhe përzihen me gjakun.

Megjithatë, kjo përthithje përmes lëkurës është shumë e vogël dhe e ngadaltë. Për më tepër, ky veprim nuk përbën ngrënie apo pirje.

Prandaj, pomadat që lyhen në lëkurë dhe fashat me ilaç që ngjiten në trup nuk e prishin agjërimin.

#### **56. A e prish agjërimin trajtimi dentar?**

Vetë trajtimi i dhëmbëve nuk e prish agjërimin. Edhe injeksionet që bëhen për ta shmangur dhimbjen gjatë trajtimit, meqenëse nuk kanë qëllim ushqyes, nuk e prishin agjërimin.

Megjithatë, gjatë trajtimit, nëse për shkak të ndonjë procedure tjetër – p.sh. gjatë shpëlarjes së gojës – në fyt depërton

ujë, gjak ose ndonjë nga substancat e përdorura në trajtim, atëherë agjërimi priset dhe duhet të bëhet kaza.

### **57. A e prish agjërimin gjakderdhja e dhëmbëve dhe gëlltitja e gjakut të përzier me pështymë?**

Gjakderdhja e dhëmbëve nuk e prish agjërimin.

Megjithatë, nëse gjaku që del është i barabartë ose më i madh në sasi se pështyma me të cilën përzihet dhe gëlltitet, atëherë agjërimi priset dhe duhet të bëhet kaza.

Nëse sasia e gjakut është më e vogël se pështyma, kjo nuk merret parasysh dhe agjërimi nuk priset.

### **58. A e prish agjërimin gëlltitja e tabletës pa ujë?**

Nëse një person që agjëron, pa pasur ndonjë arsye të vlefshme, gëlltit një substancë ushqimore ose ilaç – qoftë me ujë apo pa ujë – agjërimi i priset dhe kërkohet *kefaret*.

Por nëse ilaçi merret për shkak të një shqetësimi shëndetësor që e bën të lejueshme prishjen e agjërimin, atëherë agjërimi priset dhe kërkohet vetëm kaza, jo kefaret.

**59. Ata që e kalojnë Ramazanin dhe Bajramin në vende të tjera, nëse llogaritjet/takvimet e atij vendi ndryshojnë nga vendlindja, a duhet ta festojnë Bajramin sipas vendlindjes apo sipas vendit ku ndodhen?**

Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve (*fakihëve*), muajt hënorë fillojnë me shikimin e hënës së re (*hilalit*) pas përdimit të diellit, nëse ajo shihet nga ndonjë vend i tokës.

Sot, me anë të llogaritjeve astronomike, mund të përcaktohet me saktësi se ku dhe kur mund të shihet hëna e re. Në vendin tonë dhe në shumicën e vendeve islame, kalendaret përgatiten sipas këtyre llogaritjeve dhe Ramazani e Bajramet përcaktohen në përputhje me to.

Disa vende të pakta islame, në përcaktimin e fillimit të muajve hënorë, e marrin për bazë jo momentin kur hëna mund të shihet, por momentin e bashkimit (*ixhtima*) ose shikimin e *hilalit* brenda territorit të tyre. Për këtë arsye, në botën islame ndodh që disa vende të fillojnë agjërimin ose të festojnë Bajramin një ditë para ose një ditë pas nesh.

Këto dallime që burojnë nga interpretimet juridike (*ixhtiha-det*) nuk e dëmtojnë adhurimin e askujt.

Prandaj, një musliman që ndodhet në një vend tjetër duhet ta festojë Bajramin sipas vendit ku ndodhet dhe ta përjetojë gëzimin e Bajramit së bashku me muslimanët e atij vendi.

## V. GRATË NË GJENDJET E VEÇANTA DHE AGJËRIMI

### **60. A mund të agjërojnë gratë gjatë ditëve të tyre të veçanta?**

Një grua gjatë periudhës së saj mujore (*haja*) e ka të ndaluar të falë namaz dhe të agjërojë. Namazi dhe agjërimi i saj në këtë gjendje nuk janë të vlefshme. Juristët islamë janë në një mendim (*ixhma*) për këtë çështje.

Ekziston gjithashtu pajtim i plotë i medhhebeve se namazet e lëna gjatë periudhës mujore nuk bëhen kaza, ndërsa agjërimet e lëna duhet të kompensohen pas pastrimit.

Ky konsensus mbështetet në hadithet e Muhammedit s.a.v.s. dhe në praktikën e sahabëve. Në të vërtetë, hz. Aisheja r.a., kur u pyet për këtë çështje, tha se në kohën e të Dërguarit s.a.v.s., kur gratë kishin menstruacione, urdhëroheshin t'i kompenzonin agjërimet e lëna, por nuk ngarkoheshin me kompensimin e namazeve (Buhariu, Hajd, 20; Muslimi, Hajd, 69).

### **61. Si duhet të agjërojë një grua që ka gjakderdhje të çrregullt menstruale?**

Gratë gjatë periudhës së menstruacioneve nuk falin namaz dhe nuk agjërojnë. Pas pastrimit, namazet e lëna nuk i bëjnë kaza, ndërsa agjërimet i kompensojnë (Buhariu, Hajd, 20;

Muslimi, Hajd, 69; Eba Davudi, Taharah, 106; Tirmidhiu, Taharah, 97).

Numri i ditëve të menstruacioneve nuk është i njëjtë për çdo grua. Sipas medh'hebit hanefi, kohëzgjatja minimale është tre ditë, ndërsa maksimalja dhjetë ditë. Kohëzgjatja përcaktohet sipas përvojës së mëparshme të gruas.

Në rastet e gjakderdhjeve të çrregullta, gjakderdhja që zgjat nga tre (3) deri në dhjetë (10) ditë konsiderohet menstruacion; gjatë këtyre ditëve agjërimi lihet dhe më pas bëhet kaza. Pas plotësimit të dhjetë ditëve, merret gusël dhe fillohet namazi dhe agjërimi.

Periudha e pastërtisë ndërmjet dy menstruacioneve nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

## **62. Çfarë duhet të bëjë një grua që ka bërë nijet për agjërim, por gjatë ditës i vijnë menstruacionet?**

Gratë gjatë periudhës së menstruacioneve (*hajd*) dhe lehonisë (*nifas*) nuk falin namaz dhe nuk agjërojnë. Më pas, agjërimet e lëna i kompensojnë (*kaza*).

Nëse një grua ka bërë nijet për agjërim dhe gjatë ditës i vijnë menstruacionet, ajo e prish agjërimin dhe pas përfundimit të menstruacionit ajo vazhdon t'i agjërojë ditët e tjera. Pas Ramazanit, këto ditë – bashkë me ditën kur i erdhën menstruacionet - ajo do t'i bëjë kaza.

Nuk është e drejtë që ajo të vazhdojë të sillet si agjërueshëm deri në iftar. Megjithatë, duke e respektuar ndjeshmërinë e

Ramazanit, është e përshtatshme që ajo të mos hajë e të mos pijë në prani të të tjerëve.

### **63. A është e lejueshme që gratë në Ramazan të përdorin ilaçe për shtyrjen e menstruacioneve?**

Periudha e menstruacioneve është pengesë për agjërimin. Agjërimi i mbajtur në këtë gjendje nuk është i vlefshëm.

Megjithatë, nëse për shkak të përdorimit të ilaçeve që e shtyjnë menstruacionin nuk ndodh gjakderdhja, atëherë nuk konsiderohet se ka filluar periudha mujore dhe agjërimi i mbajtur është i vlefshëm.

Por, duke qenë se me anë të gjakut menstrual trupi nxjerr jashtë disa substanca të dëmshme të grumbulluara, nga pikëpamja shëndetësore nuk rekomandohet përdorimi i ilaçeve për t'i penguar menstruacionet.

### **64. A mund të agjërojnë gratë gjatë shtatzënisë?**

Një nga arsytet e vlefshme për të mos agjëruar në Ramazan është shtatzënia ose gjidhënia. Gratë shtatzëna ose ato që e ushqejnë fëmijën me gji, nëse kanë frikë se agjërimi mund t'u shkaktojë dëm atyre ose fëmijës, mund të mos agjërojnë. Ato, në njëfarë mënyre, konsiderohen në gjendje të ngjashme me të sëmurin; për më tepër, ekzistojnë edhe hadithe që ua japin këtë lehtësim (Nesaiu, Sijam, 51, 62; Ibnu Maxhe, Sijam, 12).

Nëse gruaja shtatzënë ose ajo që ushqen me gji ka mundësi të agjërojë pa u dëmtuar as ajo dhe as fëmija, mund të agjëro-

jë. Në këtë çështje është e përshtatshme të konsultohet një mjek specialist.

Gratë që nuk agjërojnë për arsye të ligjshme si shtatzënia apo gjidhënia, i kompensojnë (kaza) agjërimet e lëna në një kohë tjetër kur kushtet janë të përshtatshme.

## **65. A mund të agjërojë një grua që ka pasur abort?**

Gjykimi nëse një grua që ka pasur abort mund të agjërojë apo jo, lidhet me faktin nëse aborti konsiderohet shkak për *nifas* (lehoni) apo jo.

Sipas medh'hebit hanefi dhe hanbeli:

– Nëse fetusit i abortuar ka pasur gjymtyrë të dallueshme si dorë, këmbë apo gishta, gjaku që del konsiderohet gjak *nifasi* dhe gruaja trajtohet si lehonë.

– Nëse aborti ka ndodhur para se të dallohen këto gjymtyrë, gjaku konsiderohet *istihada* (gjak i parregullt), jo *nifas*.

Megjithatë, ky gjykim është dhënë në periudha kur dallimi midis fetusit dhe një mase tjetër ishte i mundur vetëm me anë të shenjave të jashtme si formimi i gjymtyrëve. Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme sipas njohurive mjekësore të kohës së tyre.

Prandaj, sot duhet të merren parasysh të dhënat bashkëkohore mjekësore. Nëse nga ana mjekësore vërtetohet se ajo që ka dalë është fetus, atëherë gjaku pas abortit konsiderohet *nifas* (lehoni).

Sipas medh'hebit shafi'i dhe maliki, çdo abort është shkak për *nifas*.

Si përfundim, nëse dihet se ajo që ka rënë është fetus – pavarësisht nëse gjymtyrët janë të dallueshme apo jo – gruaja u nënshtrohet rregullave të lehonisë dhe nuk mund të agjërojë. Këto ditë më vonë do t'i bëjë kaza.